



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 471/4 Prot.

Tiranë, më 20.04.2022

V E N D I M

Nr. 75, Datë 20.04.2022

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 53, datë 23.03.2022¹, e A.D kundër Bashkisë Tiranë², në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjinisë” dhe “çdo shkak tjetër³”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe me shkresën datë 29.03.2022, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Jam i divorcuar me vendim të Gjykatës të formës së prerë, që në vitin 2014. Në vitin 2016, djali jonë i mitur me Vendimin nr. 10632, datë 13.12.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe Vendimin nr. 765, datë 01.10.2019 të Gjykatës së Apelit Tiranë, kaloi ligjërisht me mua. Ish bashkëshortja, M.Ç ka detyrim ushqimor të pa përmbushur asnjëherë për fëmijën e mitur, sipas vendimit gjykatës.

Në nëntor 2019 ndodhi tërmeti i cili shkaktoi probleme në pallatin tonë, në banesën tonë të vetme të ligjshme. Këtë shtëpi me mirëkuptim në gjykatë e kishim ndarë 50% me 50% dhe zonja kërkoi ta blinte dhe me vendim gjykate ramë dakort që ajo ta blinte e të shlyente detyrimin brenda një viti. Kaluan 4 vjet dhe ajo nuk pagoi, por apeloj marrëveshjen në Gjykatën e Apelit. Me shkresën nr. 15326, datë 06.12.2019, Zyra e Përmbartimit Gjyqësor Tiranë, vendosi fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm të Titullit Ekzekutiv të Vendimit të Ndërmjetëm nr. 10632, datë 13.12.2017, të Gjykatës Tiranë dhe ju drejtua gjithë institucioneve për detyrimin për fëmijën e mitur, që zonja nuk ka shlyer asnjë lek, si dhe Drejtorisë Vendore të ASHK Tiranë, ku me shkresën përgjigje, duket qartë që zonja nuk figuron ligjërisht në hipotekë në momentin që ka aplikuar për dëmshpërblim nga rindërtimi.

Në bazë të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për Përballimin e Pasojave të Fatkeqësisë Natyrore”, që të aplikojë për të përfituar nga programi i rindërtimit duhet të plotësohen disa

¹ Ankesa është plotësuar me dokumentacion në datë 29.03.2022.

² - Njësisë Administrative nr. 1, - Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësisë Administrative dhe Emergjencave Civile, - Komisionit të posaçëm për vlerësimin e kërkesave dhe përzgjedhjen e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit në Bashkinë Tiranë.

³ Pa përcaktuar një cilësi personale apo shkak.

kritere sipas ligjit, certifikatë prone, certifikatë familjare, etj. Në muajt Tetor 2020-Shkurt 2021, kam qenë me Covid-19, dhe për disa muaj në spital jashtë shtetit. Pas Vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 35, datë 01.03.2021, që bënte fjalë për prishjen e pallatit tonë, nga muaji mars 2021 shkova në Njësinë Administrative nr. 1 dhe kërkoja informacion dhe më thanë se nuk dinë gjë dhe se askush nuk ka aplikuar apo përfitur bonuse apo financime për shtëpinë time, nga pasojat e tërmetit. Unë sipas përgjegjësit të zyrës së urbanistikës, nuk aplikoj dot për përfitim financiar, sepse kishte kaluar afati dhe askush nuk kish përfitur për shtëpinë time. Në datë 14.05.2021, i jam drejtuar me shkresë Njësisë Administrative nr. 1, ku i kërkoj që si posedues i ligjshëm në atë shtëpi, të më informonin për hapat ligjorë dhe administrativë që kjo bashki ndiqte, duke ju dërguar dhe një kopje të certifikatës së pronësisë së shtëpisë, por nuk mora përgjigje.

Me shkresën nr. 1850, datë 02.06.2021 i drejtohem Njësisë Administrative nr. 1, me kërkesë për informim, ku i kërkoj që nga ana e zyrave ligjore të saj dhe zyrës së financës, nëse ka likuiditete financiare për ish bashkëshorten, kërkesë e cila është shoqëruar dhe me vërtetimin e Përmbartimit Gjyqësor Tiranë, datë 28.05.2021 të përmbartuesit A.F. Njësia Administrative nr. 1, kthen përgjigje me shkresën nr. 1850, datë 07.06.2021, ku bën me dije se ekzekutimi i vendimeve përmbartimore nuk është kompetencë e Njësisë Administrative nr. 1. Nisur nga kjo përgjigje jo etike dhe shqetësuese por edhe se kisha dëgjuar se për shtëpinë time ishin dhënë fonde financiare, shkova pranë zyrës së financës dhe shërbimit social në Njësinë Administrative nr. 1, dhe B.Gj, e cila ishte Përgjegjëse për Shërbimin Social, debaton duke më thënë se nuk je gjinia femërore që të trajtoheshe dhe ti, ndaj kemi bërë siç dinim vetë në kriteret për vlerësimin e shtëpisë nga tërmeti.

Në datë 19.11.2021 i bëj kërkesë për informim, në një letër të përbashkët Adminstratores së Njësisë Administrative nr. 1, Drejtorisë së Emergjencave Civile dhe Drejtorisë së Përgjithshme të objekteve në bashkëpronësi, dhe për dijeni Kryetarit të Bashkisë Tiranë, ku u kërkoj informacion në lidhje me dëmshpërblimin financiar të Pallatit 104, hyrja 2, me nr. pasurie 1-765, 2-7 hyrja dy, ap. 7, rruga Ali Demi, Tiranë. Me shkresën nr. 3747/1, datë 01.12.2021 të Njësisë Bashkiake nr. 1, jam njoftuar ndër të tjera se M.Ç paska aplikuar në programin “Shtëpia ime” me nr. aplikimi 19061, datë 13.02.2020, dhe nga Instituti i Ndërtimit është vlerësuar me shkallë dëmi DS2, me VKB nr. 146, datë 30.10.2020, ajo është fituese për të gjithë banesën dhe dosja si përfituese ndodhet në Bashkinë Tiranë. Ankuesi në përfundim informoi se M.Ç ka aplikuar në datë 13.02.2020 dhe është shpallur përfituese në 30.10.2020. Ankuesi shtron pyetjet se me çfarë certifikatë pronësie, me çfarë certifikate familjare ka përfitur M.Ç dhe a ka përfitur shumë financiare nga pjesa e tij takuese?”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit për shkak të gjinisë nga ana e Bashkisë Tiranë.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat

e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3/1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, Komisioneri konstaton se:

Për shkak të fatkeqësisë natyrore si shkak i tërmetit që preku Shqipërinë më datë 26 Nëntor 2019, Këshilli i Ministrave miratoi Aktin Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për Përballimin e Pasojave të Fatkeqësisë Natyrore”, i cili në Nenin 18, pika 7 të tij ka parashikuar se: “7. Kushtet, kriteret, kategoritë prioritare, procedurat dhe rregullat për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit, përfshirë dhe autoritetet përgjegjëse shtetërore, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Përfituesit nuk mund të përfitojnë në të njëjtën kohë nga më shumë se një program i procesit të rindërtimit për qëllime strehimi, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë akt. Autoritetet përgjegjëse marrin masa që subjektet të cilat nuk përfitojnë nga një program i caktuar, të kenë mundësi për të kaluar në një program tjetër të procesit të rindërtimit, sipas kushteve dhe procedurave të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave. Subjektet përfituese nga programet e procesit të rindërtimit konsiderohen që shpërblehen, jo më shumë se vlera e dëmit real të përbërë nga humbja e pësuar e jetës së njeriut dhe/ose vlera e dëmeve pasurore”, ndërsa në nenin 5, pika 4 përcaktohet se: “Individët dhe familjet, banesa e të cilëve është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore, por që nga autoritetet përgjegjëse është vlerësuar si e banueshme, nëse nuk kanë përfitur nga ndonjë program tjetër i procesit të rindërtimit, përfitojnë kompensimin e dëmeve, sipas parashikimeve të këtij akti”.

Në zbatim të aktit të mësipërm, Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, ka përcaktuar se: “1. 2.

3. Aplikimi për të përfituar nga programet e procesit të rindërtimit sipas parashikimeve të këtij vendimi bëhet me dy faza. Në fazën e parë aplikantët paraqesin kërkesën e tyre për të përfituar nga programet e procesit të rindërtimit. Në fazën e dytë të aplikimit përfshihen vetëm ata/o individë/familje që janë përzgjedhur për t’u trajtuar me njërin prej këtyre programeve.

4. Përfshirja në programet e rindërtimit bëhet nëpërmjet aplikimit në njësinë e vetëqeverisjes vendore ku individi/familja ka vendbanimin, sipas modelit dhënë në shtojcën A, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe sipas deklaramentit tip për vërtetësinë e të dhënave, dhënë në shtojcën B, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Aplikimi paraqitet drejtpërdrejt në strukturën/at përgjegjëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore ose në zyrën e qëndrimit me një ndalesë të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në rast se ka një të tillë. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të vendosin që këto kërkesa të paraqiten pranë njësive administrative ku individët kanë vendbanimin.

6. Aplikimet për përfitimin nga programet e rindërtimit duhet të jenë në formë të shkruar. Ato regjistrohen dhe përpunohen nga struktura/t përgjegjëse të njësive të vetëqeverisjes vendore në një sistem elektronik”.

8. Kërkesat e plotësuara me të dhënat dhe dokumentacionin sipas parashikimit të këtij vendimi regjistrohen sipas rendit kronologjik në sistemin e posaçëm elektronik nga strukturat përgjegjëse. Regjistri i kërkesave përmban informacionin që mundëson përpunimin e të dhënave, si më poshtë vijon: a) emrin, atësinë, mbiemrin; b) numrin e kërkesës; c) datën e dorëzimit/paraqitjes së aplikimit; ç) objektin e kërkesës, përfshirë edhe preferencën e paraqitur për programin e rindërtimit; d) adresën e kërkuarit; dh) përbërjen familjare në momentin e aplikimit; e) Aktin e konstatimit/aktekspertizën e thëlluar, të lëshuar nga çdo person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës tregtare, i pajisur me lejen, licencën ose autorizimin përkatës nga autoritetet shtetërore për vërtetimin e gjendjes së rrezikut për jetën dhe shëndetin, në të cilin vërtetohen dëmet që ka pësuar ndërtesa apo që është shpallur si e pabanueshme; ë) dokumentin e pronësisë ose çdo akt për fitimin e pronësisë së banesës së dëmtuar.

Në shqyrtim të legjislacionit të sipërcituar, rezulton se Këshilli i Ministrave ka parashikuar se për të përfituar nga programet e rindërtimit, subjektet individë/familje, duhet të aplikojnë në njësitë e vetëqeverisjes vendore për të përfituar nga njëri prej programeve të rindërtimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, rezulton se ankuesi, A.D nuk ka aplikuar⁴ asnjëherë për të përfituar nga programet e rindërtimit, ndërsa M.Ç rezulton se ka aplikuar për të përfituar nga programet e rindërtimit.

⁴ Referuar shkresës nr. A-27007/1, datë 06.12.2021 të Drejtorisë së Rindërtimit të Emergjencave, të Bashkisë Tiranë “...në Drejtorinë e Rindërtimit të Emergjencave nuk është depozituar dosje në emrin e A.D....”.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në neni 33/4, gërma “ç”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në të cilin parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;”, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet, pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

- Në ankesën e paraqitur, rezulton se ankuesi ka dhënë informacion dhe dokumentacion të korrespondencës që ka pasur me institucione të ndryshme të Bashkisë Tiranë, lidhur me kërkesat për transparencë dhe informim të tij nga ana e këtyre institucioneve për procesin e përfitimit nga ana e M.Ç, nga programet e rindërtimit, por nuk ka depozituar asnjë akt që të vërtetojë pretendimin e tij për trajtim të pabarabartë nga ana e Bashkisë Tiranë, në raport me ish bashkëshorten, për shkak të gjinisë, gjatë procesit të aplikimit për të përfituar nga një prej programeve të rindërtimit. Ankuesi ka depozituar pranë Komisionerit, shkresat drejtuar institucioneve të Bashkisë Tiranë, në të cilat në mes të tjerash ka kërkuar informacion mbi dokumentacionin e pronësisë që ka dorëzuar ish bashkëshortja dhe dëmshpërblimin që ka përfituar ajo nga programi i rindërtimit, por jo që të kishte aplikuar vetë për të përfituar nga programet e rindërtimit.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara e pretendimeve të subjektit ankues, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës.

Lidhur me informacionin dhe dyshimet e ngritura nga ankuesi se: “M.Ç ka aplikuar në datë 13.02.2020 dhe është shpallur përfituese në 30.10.2020, me çfarë certifikatë pronësie, me çfarë certifikate familjare, a ka përfituar shumë financiare nga pjesa ime takuese?”, Komisioneri vlerëson se këto dyshime, ankuesi duhet ti adresojë pranë organeve kompetente të zbatimit të ligjit.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa a), nenit 33, pika 4/ç, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 53, datë 23.03.2022, të paraqitur nga shtetasi A.D, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA